



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E VUSHTRISË



Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Njoftim për diskutim publik

Vushtrri, 26 Janar 2018

Të nderuar qytetarë!

Në mbështetje të udhëzimit administrativ (MTI) Nr.01/2014, për përcaktimin e procedurës së paraqitjes së kërkesës për marrjen e pëlqimit, procedimit të saj dhe dhënien e pëlqimit, mënyrën dhe procedurat për konsultim publik, si dhe përmbajtja e regjistrit të zonave ekonomike, gjegjësisht të nenit 6, pika 1,3 dhe 4, Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, ka vënë në diskutim publik shpalljen publike për zonën ekonomike, përkatësisht “Park Industrial”:

- Shpalljen publike për krijimin e zonës ekonomike, përkatësisht “Parkut Industrial”, në lokacionin e fshatit Lumadh e cila ka një sipërfaqe prej 14,86 Ha.

Prandaj ftojme qytetarët, OJQ-të, grupet e shoqërisë civile, biznesit dhe grupeve tjera, që të japin propozimet, vërejtjet dhe sugjerimet e tyre për zonën ekonomike, para aprovimit final, propozimet tuaja janë të mirëpritura.

Diskutimi publik është i hapur që nga data 26/01/2018 dhe zgjat 30 ditë, gjegjësisht deri më 27/02/2018, ku me datën 28/02/2018(e Mërkure) është paraparë të bëhet një rezyme e përgjithshme nga debati publik, i cili do të mbahet në sallën e Kuvendit Komunal, që nga ora 10:00.

Me respekt,
Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Kontakt:

Tel: 044 213 297

e-mail: miran.halili@rks-gov.net

Lokacioni i destinuar për Parkun e Biznesit në Lumadh

